

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Sahit Krasniqi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit D.T., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së PPQ në Prishtinë PP.nr. 902-1/2011 të datës 10.02.2012, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të akuzuarit me mbrojtësit e tij me autorizim av. H.Zh. dhe av. A.I. dhe të dëmtuarit A.C.1, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 08.05.2014, 05.06.2014, 30.06.2014, 30.07 dhe 01.08.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D.T.**, nga i ati M. dhe e ëma Sh. e gjinisë M., data e lindjes në fshatin ... Komuna e Kaçanikut, me vendbanim në të njëjtin vend, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar babë i një fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike.

Në bazë të nenit 390 par. 1 nënpar. 3 të KPPK-së.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse natën e 28.11.2011, rreth orës 03:30, në fshatin doganaj, Komuna e Kaçanikut, ka tentuar të kryej veprën penale të vrasjes dhe ta privojë nga jeta A.C.1, nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, në atë mënyrë që kishte shkuar deri në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit me armë zjarri-me revole në dorë dhe i dëmtuari e kishte vërejtur dhe kishte ngarë pas tij me një guri në dorë, e ka arritur dhe pas kësaj ka ardhur deri te kacafytja e ndërsjellë e pastaj i pandehuri duke shfrytëzuar momentin e volitshëm ka shtënë në të dëmtuarin A.C.1 në pjesën shpatullës së majtë me ç'rast predha ka depërtuar dhe ka dalë në shpatullën e djathtë,

duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit plagosje trupore dhe pas kësaj ka ikur, kurse i dëmtuari A.C.1 për të iu ofruar ndihma mjekësore është dërguar në Shtëpinë e Shëndetit në Ferizaj e nga aty në Klinikën Kirurgjike të Qendres Klinike Universitare në Prishtinë, ku është hospitalizuar për shërim të mëtutjeshëm,

- meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka kryer në tentativë veprën penale vrasja nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

nga data e pavërtetuar deri më datën 27.11.2011 ka poseduar armë pa leje valide të cilën ka përdor natën e sipërmendur rreth orës 03:30, ku me armë-revole ka shtënë në të dëmtuarin A.C.1 dhe atë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit në fshatin ..., Komuna e Kaçanikut, kurse armën-revolen e ka fshehur dhe nuk ua ka dorëzuar personave të autorizuar,-

- meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par.1 të KPK-së

I dëmtuari A.C.1, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 902-1/2011 të datës 10.02.2012, ndaj të akuzuarit D.T., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nënpar.4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr.129/2012 të datës 23.03.2012, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarit për veprat penale në fjalë, kurse

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin e saj P.nr.189/2012 të datës 10.02.2012, shpalli fajtor të akuzuarin, duke i shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 vite.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin e saj PAKR.nr.1631/2012 të dt. 06.02.2014, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit ashtu që ka anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer për rigjykim.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 08.05.2014, 05.06.2014, 30.06.2014, 30.07 dhe 01.08.2014, kurse Prokurori i Shtetit Rasim Maloku, para fjalës përfundimtare ka bërë ricilësimin e veprës penale siç është paraqitur në versionin e këtij aktgjykimi, kurse në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë akuzës së ndryshuar dhe i ka propozuar Gjykatës, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me ligj.

2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari D.T., në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës dhe më tutje ka sqaruar se jeton në fsh. ... Komuna e Kaçanikut i cili fshat është në kufi me fsh. Dubravë, Doganaj dhe Sllatinë, përndryshe tani të dëmtuarin A.C. e njeh prej shumë kohësh së pari në faktin se në shtëpinë e tij ka punuar gjatë kohës kur i njëjti ishte duke bërë lyerjen e shtëpisë dhe kjo ka qenë diku në vitin 2008 përndryshe A.1 e njeh edhe nga fakti se i njëjti ka punuar edhe taksist pas orarit të punës pasi i njëjti ka punuar në fabrikën “...” dhe këto fakte i di se fshati i tij dhe fshati ku banon i dëmtuari janë afër njëri tjetrit rreth 1 km. Përkitazi me rastin që i ka ndodhur A.1 ka dëgjuar të nesërmen nga pronari i marketit “...” H.D., e po ashtu këtë e ka dëgjuar edhe nga një person tjetër A.S. në momentin kur ka shkuar në shitore për të blerë cigare. Më tutje në mbrojtjen e tij ka shtuar se natën kritike kur ka ndodhur ngjarja ka qenë në shtëpi së bashku me nënën, babanë dhe motrat e që paraprakisht ka qenë në mal duke bartur drunjë, kurse më tutje ka përkthuar raportet me të dëmtuarin A.C.1 si raporte shumë të mira por edhe me familjen e tij asnjëherë asnjë të keqe nuk ka pasur, kurse sa i përket motivit shton se nipi i tij N.C. ka biseduar edhe me persona tjerë për rastin dhe se “...në fund e ka gjetur më butë tek unë” dhe për këtë arsye e kanë akuzuar.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 387 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akzuarit;
- nga dëgjimi i dëshmitarit – të dëmtuarit A.C.1, dëshmitarëve B.K., D.V., B.V., RR.K., F.C., Sh.M. dhe D.R.;
- nga ballafaqimi mes të akzuarit dhe dëshmitarit – të dëmtuarit A.C.1;
- nga leximi në raportin e vëzhgimit të vendit të ngjarjes bashkë me foto dokumentacionin e teknikës kriminalistike të Policisë së Kosovës – Njësia e Hetimeve Ferizaj;
- nga leximi i fletëlëshimit të QKUK-së në Prishtinë i dt. 05.12.2011;
- nga shikimi dhe leximi në raportin e forenzikës të dt. 29.11.2011;

4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata vlerëson të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

- se me datë 28 nëntor 2011, rreth orës 03:30, në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit A.C.1 në fshatin ... ka ndodhur një kacafytje mes të të dëmtuarit dhe një personi tjetër;
- me atë rast fillimisht dy herë është shtënë me armë në drejtim të të dëmtuarit;

- e më pastaj ka filluar përleshja me ç'rast një herë është qëlluar me armë zjarri i dëmtuari A.C.1 duke u goditur në pjesën e shpatullës së majtë dhe predha duke depërtuar deri në shpatullën e djathtë dhe duke i shkaktuar të dëmtuarit lëndime trupore;

- se arma e përdorur bazuar në gëzhhojen e gjetur në vendin e ngjarjes ka qenë e shkrepur nga një armë e kalibrit 7.62X39mm.

Faktet që u potencuan më lartë, paraqesin edhe dilemën e krijuar përkitazi me faktin se në fakt kush ishte personi që kreu aktin e shkrepjes me armë përkatësisht aktin e tentim vrasjes dhe se i akuzuari a ishte personi i cili ndërmoi veprimet të përshkuara në akuzë, andaj Gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor është përqendruar në vërtetimin e kësaj rrethane nga shkaku se enigmatike ka qenë pikërisht ky fakt e cila edhe sipas instruksioneve të Gjykatës së Apelit të Kosovës e shprehur përmes vendimit të saj ka potencuar se nuk është ndriçuar në mënyrë bindëse dhe të pakontestueshme në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor.

Pra, Gjykata ka pasur për detyrë që të ndriçoj në këtë çështje penale dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore, shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor e po ashtu edhe në këtë shqyrtim gjyqësor dhe atë versionin e Prokurorit të Shtetit (se vepra penale është kryer nga i akuzuari) dhe versionin e akuzuarit dhe mbrojtësit të tij (se i akuzuari nuk e ka kryer këtë vepër penale), andaj Gjykata e ndodhur mes këtyre dy versioneve tërë arsyetimin e këtij aktgjykimi do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit të dëmtuarit A.C.1 është vërtetuar se me dt. 28.11.2011 diku rreth orës 03:30 të mëngjesit pasi është zgjuar nga gjumi me qëllim që të shkoj në ahur tek lopët dhe te dera e hyrjes ka parë pikërisht tani të akuzuarin D.T. i cili ka qenë në oborr e tij dhe pas bisedës me të i njëjti ka shkrepë dy herë në drejtim të tij por nuk e ka qëlluar deri sa ka vazhduar duke shkuar në drejtim të tij dhe kanë filluar kacafytja mes tyre deri sa në kacafytje e sipër ka shkrepur edhe një herë me revolen e tij duke e qëlluar në shpatullën e majtë ashtu që plumbi ka depërtuar deri në shpatullën e djathtë dhe pas kësaj i njëjti është larguar nga aty duke ikur në drejtim të rrugës që shpie për Brezovicë dhe Ferizaj. Më tutje i dëmtuari ka vazhduar me dëshminë e tij duke treguar se ka hyrë në shtëpi deri sa bashkëshortja dhe tre fëmijët e tij kanë qenë duke fjetur e pasi që të njëjtit nuk kishin dëgjuar e ka thirr bashkëshorten duke i thënë se “jam kacafytur në oborr me një hajn” dhe pasi që e kanë parë duke i rrjedhë gjak e kanë thirrë në telefon vëllain e tij me qëllim që të e dërgojnë në Spital e që e kanë dërguar fillimisht në Spitalin e Ferizajt, në automjet së bashku me

vëllain e tij, F.C. (kushëri i tij) dhe A.C.2 (vajza) dhe pastaj për trajtim të mëtejshëm është dërguar në QKUK në Prishtinë. Dëshmitari më tutje ka potencuar faktin se është i sigurve se personi me të cilin ka pasur konflikt ka qenë pikërisht D.T. me që edhe me fshatra janë afër njëri -tjetrit përndryshe e njeh edhe nga fakti që shumë vite ka punuar taksistë pasi e ka transportuar disa herë me veturë, kurse posaçërisht ka potencuar faktin se tri drita kanë qenë të vendosura në shtëpinë e tij pikërisht në ballkonin e katit të parë dhe ka pasur ndriçim të mjaftueshëm dhe e ka parë mirë të akuzuarin se në kokë ka pasur të vendosur një kapuq, një kaput (palltë) i cili ka qenë deri tek mbi gjuri, këpucë të zeza dhe një çantë në krah që përafërsisht ka qenë e madhësisë së çantave që bartin nxënësit në shkollë.

Po ashtu dëshmitari- i dëmtuari ishte konsekuent se i akuzuari ishte personi i cili e sulmoi edhe me rastin e ballafaqimit me të akuzuarin i cili ballafaqim është bërë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, por megjithatë dëshmitari e po ashtu edhe i akuzuari mbetën pranë qëndrimeve të tyre.

Në cilësinë e të dëmtuarit i është bashkëngjitur ndjekjes penale dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike të cilën nuk ka mundur ta precizoj në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari dhe atë për dy arsye: së pari se në fakt ishte dëshmitari i vetëm okular i ngjarjes së ndodhur dhe së dyti për faktin se për shkak të gjendjes së tij të kuptueshme emocionale meqë ka qenë i dëmtuar me këtë vepër penale megjithatë dëshmia e tij pjesërisht ishte e saktë dhe plotë për më tepër edhe konsistente që prej dëgjimit të parë policor e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, por vetëm në aspektin objektiv se ngjarja ka ndodhur pikërisht siç ka dëshmuar dëshmitari (se ishte shtënë dy herë në drejtim të tij pastaj ishte kacafytur me sulmuesin dhe se gjatë kacafytjes ishte shtënë edhe një herë dhe ishte qëlluar në pjesën e shpatullës së majtë), meqë këto fakte mbështeten edhe përmes provave materiale (ekspertiza forenzike, shikimi në vendin e ngjarjes dhe raportet mjekësore), kurse sa i përket pjesës së dëshmisë së tij, përkitazi me aspektin subjektiv përkatësisht kryesin e veprës penale, Gjykata të njëjtit në mënyrë absolute nuk i besoi kësaj dëshmie dhe atë për faktet që hollësisht do të elaborohen më tutje:

- së pari është e palogjikshme dhe atipike që menjëherë pas ngjarjes dëshmitari të mos tregoj personin i cili e kishte sulmuar edhe pse familjarët e tij të ngushtë (bashkëshortja dhe fëmijët) e më vonë vëllai dhe kushërinjë ishin aty dhe përkundër kësaj nuk iu kishte thënë asgjë lidhur me personin që e kishte sulmuar por siç e pohon edhe në shqyrtimin gjyqësor u

ka thënë “...jam kacafytur në oborr me një hajn...”¹ që tregon se i njëjti megjithatë nuk po e dinte se kush ishte hajni, meqë po ta dinte identitetin e tij ishte e natyrshme që menjëherë të iu tregonte familjarëve të tij të ngushtë për identitetin e këtij personi (hajni), meqë nuk kishte as edhe një arsye të vetme që ta fshihte këtë person;

- edhe nëse aprovohet argumenti se në ato momente nuk i kujtohej emri i të akuzuarit që është e mundshme, atëherë sigurisht se do ti kujtoheshin shumë e shumë të dhëna tjera dytësore apo më të përgjithshme që do të përcaktonte se kryes i kësaj vepre ishte pikërisht i akuzuari (fshati prej nga ishte, lagjja ku banonte, mosha e tij, emri i babait të tij) por asnjë nga ato nuk u potencuan pos faktit se u kacafyt me një hajn;

- më tutje dëshmitari potencon se edhe përkundër faktit se deri në Spitalin e Ferizajt është dërguar me automjetin e vëllait të tij dhe nga familjarët e tij (vajza, vëllai dhe kushëriri F.C.) megjithatë nuk ka treguar personin që e ka sulmuar e që është po ashtu e pashpjegueshme për faktin se është jashtë çdo logjike e në kundërshtim të plotë edhe me traditën familjare që të mos u tregohet personi që e ka sulmuar, kurse argumentet e tij se “...përndryshe transporti prej Ferizajt deri në Prishtinë është kryer me automjet të spitalit dhe gjatë kohës sa më kanë transportuar unë nuk kam pasur vetëdije deri në Prishtinë, përkatësisht unë edhe gjatë udhëtimit prej shtëpisë deri në spital po ashtu nuk kam pasur vetëdije...”² është e paqëndrueshme për më tepër demantohet edhe nga vet dëshmia e tij në pjesën se në fakt i kujtohen mirë shumë gjëra tjera dukshëm më të parëndësishme dhe periferike siç janë personat që e kanë dërguar deri në Spitalin e Ferizajt, saktësisht i potencon personat që janë kthyer pas kontrollës në Spitalin e Ferizajt “...pasi që janë bërë kontrollat në spitalin e Ferizajt në shtëpi janë kthyer edhe vëllai im edhe vajza ime...”³, vazhdimin e udhëtimit në Spitalin e Prishtinës duke përshkruar edhe personat që kanë qenë në autoambulancë “...në autoambulancë kemi qenë vetëm unë F.C., një motër medicinale dhe vozitësi...”⁴ e për më tepër duke kujtuar mirë edhe bisedën me kushëririn e tij F.C. dhe bisedën me telefonin e F.C. me një person që është prezantuar polic “...F.C. ma ka dhënë mua telefonin dhe më ka thënë që të flasë me policinë dhe unë kam biseduar me një person përmes telefonit dhe ky person më ka thënë se “jam polic”, por unë nuk i kam besuar këtij personi se është polic dhe nuk i kam treguar emrin e personit që më ka sulmuar dhe e kemi mbyll

¹ Shih faqen 5 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

² Shih faqen 6 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

³ Shih faqen 7 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

⁴ Shih faqen 8 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

telefonin,”⁵, por përkundrazi “për shkak të gjendjes së tij të rëndë shëndetësore” vetëm se nuk ka mundur ta përmend emrin e të akuzuarit, për më tepër një pjesë e dëshmisë së tij demantohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit F.C. meqë i njëjti pohon se herë pas herë ka pasur humbje të vetëdijes-kllopi që megjithatë gjatë tërë kohës ishte në gjendje që edhe të fliste meqë edhe këta të dy vazhdimisht kishin zhvilluar bisedë mes vete gjatë tërë udhëtimit deri në QKUK në Prishtinë;

- është e rëndësishme të potencohet se dëshmitari gjatë tërë dëshmisë së tij (në të gjitha fazat e procedurës penale) nuk po mund të gjente ndonjë motiv të qartë dhe bindës për sulmin duke treguar se kishte marrëdhënie të mira edhe me të akuzuarin edhe me familjarët e tij “...me familjen e të akuzuarin D.T. por edhe me të personalisht asnjë mosmarrëveshje nuk e kemi pasur as unë as familjarët e mi...”⁶, por gjithsesi si duket dëshmitari gjeti “një motiv të tij” se i njëjti kishte shkuar për të vjedhur meqë kishte dëgjuar edhe nga persona të fshatit të tij (... fshati i të akuzuarit) se ky person vjedh “...ardhjen e tij unë e mendoj vetëm për qëllime të vjedhjes dhe atë kam dëgjuar edhe nga persona të ndryshëm pra nga kam dëgjuar nga fshatarët e tij se ky person vjedh...”⁷ e që tregon qartazi se dëshmitari është influencuar nga persona tjerë padyshim edhe në saje të të kaluarës së tij;

- edhe një çështje tejet e rëndësishme që është e nevojshme që të trajtohet është edhe fakti se si dëshmitari gjatë gjitha fazave të procedurës penale as gjatë dëshmisë në polici e as te prokurori i shtetit (deri në shqyrtimin e parë gjyqësor) asnjëherë nuk tregoi faktin se për emrin e personit që e kishte sulmuar i kishte treguar F.C. dhe gjithsesi kjo nuk ka si të shpjegohet ndryshe pos me një fakt shumë të thjeshtë se kjo paraqet “adutin” e fundit të tij për ta mbështetur këtë pohim të tij dhe për ta përforcuar pozicionin e tij edhe me një dëshmitar meqë vetëm gjatë rrugëtimit në autoambulancë ishin vetëm me F.C. dhe kjo po shihej nga i dëmtuari si një mbështetje shumë e mirë pasi që edhe bëhej fjalë për kushëririn e tij me të cilin kishin raporte mjaft të mira;

- se vërtetë dëshmitari –i dëmtuari vetëm po supozonte sulmuesin tregon më së miri edhe fakti tjetër se të nesërmen pikërisht duke u bazuar në fjalët e të dëmtuarit nipi i tij (N.C.) po bisedonte me njerëz tjerë për të cilët po pretendonte se ishin sulmuesit e A.C.1 e në kontest të kësaj është edhe biseda me dëshmitarët Sh.M. dhe D.R. dhe për të dytin po ashtu pretendohet se kishte sulmuar të dëmtuarin;

⁵ Shih faqen 6 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

⁶ Po aty

⁷ Po aty

- dhe së fundi edhe vet momenti i kacafytjes e paraqet në mënyrë mjaft të qartë se në në asnjë mënyrë sulmuesi nuk ishte i akuzuari me vet faktin se i akuzuari dhe dëshmitari ishin shumë afër njëri tjetrit “*gjoks për gjoksi*”(siç shprehet edhe vet dëshmitari) megjithatë dëshmitari pohon se ishin të gjatësisë së njëjtë e që kjo nuk korrespondon me konstruktin fizik të tyre meqë edhe nga pamja fizike i dëmtuari është diku rreth 10 cm., më i gjatë se i akuzuari e që në fakt në mënyrë absolute përjashton mundësinë që sulmuesi të ketë qenë pikërisht i akuzuari.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit B.K. i njëjti ka vërtetuar se diku në fund të vitit 2011 përkatësisht natën kur ka ndodhur ngjarja ka shkuar në bastoren në fsh. ... kurse prezent kanë qenë edhe D.T., N.C., A.D. si dhe persona të tjerë, diku rreth orës 20:00 ka dal nga kjo bastore së bashku me D.T. dhe ka shkuar në restorant “...” për të ngrënë bukë kurse D. ka shkuar në drejtim të Lagjes Kolshi në fsh. Doganaj. Pas kësaj ka shkuar tek dajhtë e tij për të folur në internet me të dashnoren e tij e pastaj e ka ftuar RR.K. – taksist, i cili e ka dërguar deri tek familja e tezes dhe që ka qëndruar një kohë tek familjarët e tezës B.V. dhe D.V. diku rreth orës 22:00 të natës deri në orën 24:00 kanë shkuar në bilardo në fsh. doganaj, e më pastaj së bashku me ta është kthyer në shtëpinë e tyre kurse të nesërmen ka shkuar në shtëpi për tu përshëndetur me familjen e tij dhe menjëherë është nisur për Mal të Zi për të punuar. Më tutje dëshmitari ka pohuar se deri në stacionin e autobusëve në Prishtinë me automjetin e tij e ka dërguar B.V. dhe diku në ora 20:00 të mbrëmjes është nisur për Mal të Zi dhe atje si ka arritur e ka thirrur vëllai në telefon duke i treguar për rastin e A.C.1 dhe se po e kërkojnë policia, ashtu që menjëherë është kthyer nga Mali i Zi duke u paraqitur në stacion policor. Përndryshe dëshmitari pohon faktin se A.C. e ka njohur edhe më herët pasi që i njëjti ka punuar taksist – “Te Lushi”, përndryshe ngjajshëm edhe në dëshminë e dytë të tij ka mohuar biseda dhe kontakte me N.C. përkitazi me këtë rast.

Sa i përket dëshmisë së këtij dëshmitari i njëjti ka paraqitur të dhëna periferike për ngjarjen e ndodhur meqë i njëjti nuk ishte dëshmitar i ngjarjes pos faktit se ka sqaruar raportet në mes të tij dhe të akuzuarin se kanë qëndruar së bashku deri në ora 20:00, kurse pjesa tjetër e dëshmisë më tepër është argumentim se personalisht nuk është i ndërlidhur me rastin e kjo sidomos duke iu referuar edhe faktit se fillimisht edhe ky ishte person i dyshuar si kryerës i kësaj vepre penale⁸, por megjithatë dëshmia e tij nuk paraqet ndonjë të dhënë relevante që ndërlidhë të akuzuarin si kryes të veprës penale.

⁸ Shih procesverbalin e intervistimit të të dyshuarit B.K. i dt.07.12.2011

Kurse sa u përket dëshmitarëve B.V., D.V. dhe RR.K.⁹, asnjë nga këto dëshmi nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë të rëndësishme dhe relevante që ndërlidhen me të akuzuarin D.T. dhe se këto dëshmi kryesisht janë produkt i fillimit të procedurës penale përkatësisht procedurës hetimore dhe janë të përqendruara në marrjen e informacioneve të përgjithshme dhe se në fokus të këtyre intervistimeve fillestare dhe njëkohësisht edhe dëshmime të tyre të mëvonshme janë të natyrës që më tepër përqendrohen në përfshirje në këtë veprë penale të tani dëshmitarit B.K. meqë edhe natyra e shumicës së pyetjeve gjatë intervistimeve policore kanë theksin tek ky person (B.K.). Edhe vet procesverbali i intervistimeve policore nuk ka përmendur fare emrin dhe mbiemrin e të pandehurin ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet (pra nuk është e qartë se a është i dyshuar D.T. apo B.K.) e për më tepër këta dëshmitarë (B.V. dhe D.V.) mbështesin pohimin e B.K. se natën kritike ka qenë mysafir tek ta kurse të nesërmen ka shkuar në Mal të Zi, kurse dëshmitari RR.K. se ka bërë transportin e tij me taksi deri në fshatin Vishaj.

Dëshmitari që do të mund të ofronte të dhëna të rëndësishme në këtë çështje penale padyshim se ishte dëshmitari F.C. dhe atë për këto arsye:

- së pari se dëshmitari- i dëmtuari A.C.1 ka potencuar emrin e këtij dëshmitari vetëm (gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë) si person që kishte udhëtuar me të deri në Prishtinë dhe gjatë bisedës i kishte treguar emrin e personit që e kishte sulmuar përkatësisht emrin e D.T.;

- se dëshmitari në këtë shqyrtim gjyqësor po dëgjohej për herë të parë dhe se nuk ishte mundësia e analizës apo ballafaqimit me dëshmitë e mëparshme të tij;

- se ishte prezent menjëherë pas ngjarjes së ndodhur që në oborrin e A.1, për të vazhduar me të dëmtuarin deri në emergjencën e Ferizajt dhe pastaj edhe në Spitalin e Prishtinës;

- se njohuritë për personin që kishte kryer veprën po i ruante dhe nuk po i depononte as edhe tek organet policore;

- dhe së fundit rëndësia e dëshmisë së tij buron edhe nga fakti se kjo dëshmi është pjesë e kërkuar nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës me rastin e kthimit të kësaj çështje në rivendosje.

⁹ Shih procesverbalet e intervistimit të dëshmitarëve B.V., D.V. dhe RR.K..

Natyrshëm se tek dëshmia e këtij dëshmitari duhet analizuar perceptimin e tij për ngjarjen, ndershmërinë dhe posaçërisht saktësinë dhe sigurinë e tij e që në këtë rast trupi gjykues e ka vënë në dyshim ndershmërinë, saktësinë dhe sigurinë e tij meqë i njëjti ka pohuar fakte që janë dëgjuar nga dëshmitari- i dëmtuari A.C.1 dhe një pjesë e madhe e dëshmisë së tij është derivat i mbështetjes së dëshmisë së dëshmitarit A.C.1 e për më tepër në kontradikte e po ashtu edhe në kundërshtim edhe me vet dëshminë e dëshmitarit A.C.1 dhe atë:

- së pari nga dëshmitari në dëshminë e tij fillimisht menjëherë pas ngjarjes pohon se i dëmtuari vetëm ka përdorë fjalët *“çka më banën....., kush m’ bani,..”*¹⁰ pa përmendur as emër e as të dhëna tjera për sulmuesin;

- dëshmitari qartazi po i mbështeste pohimet e dëshmitarit A.C.1 lidhur me identitetin e sulmuesit dhe se kjo është më se e qartë dhe e natyrshme kur këto fakte ndërlidhen me afërsinë e tyre (kushërinjë) dhe marrëdhëniet e mira mes tyre;

- vërehen disa mospërputhje edhe mes dëshmisë së tij dhe dëshmisë së dëshmitarit A.C.1 deri sa dëshmitari F.C. pohon se bisedën telefonike me policin e ka zhvilluar vetëm ai *“...bisedën në mes personit që është prezantuar si polic e që unë jam i sigurt se ka qenë polic me që më vonë kam kuptuar se ka qenë nga Kaçaniku tërë bisedën telefonike e kam zhvilluar vetëm unë dhe tjetër kush nuk ka biseduar me të përkundër faktit se polici ka kërkuar që të bisedoj personalisht me A.1, por edhe pse i njëjti ka kërkuar që të flas me A.1 unë fare nuk e kam pyetur A.1 se a dëshiron të flas me policin apo jo me që e kam parë se nuk ka qenë në gjendje që të flas...”*¹¹ kurse kjo demantohet edhe nga dëshmitari A.C.1 që pohon ndryshe se *“...ka thirr dikush në telefonin e kushëririt tim F.C. dhe F.C. ma ka dhënë mua telefonin dhe më ka thënë që të flasë me policinë dhe unë kam biseduar me një person përmes telefonit dhe ky person më ka thënë se “jam polic”, por unë nuk i kam besuar këtij personi se është polic dhe nuk i kam treguar emrin e personit që më ka sulmuar dhe e kemi mbyll telefonin...”*¹².

- një element i rëndësishëm i dëshmisë së këtij dëshmitar padyshim është fakti se cila ishte arsyeja që dëshmitari po e mbante të fshehur informatën që e kishte lidhur me identitetin e sulmuesit e që është diçka tejet me interes për të dhe dëshmitarin A.C.1, pse në fakt

¹⁰ Faqja e 15 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

¹¹ Faqja e 6 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

¹² Po aty

dëshmitari zgjodhi heshtjen deri në shqyrtimin gjyqësor dhe deri atëherë nuk po e tregonte këtë fakt edhe pse kishte kontakte edhe me policinë “...në shtëpi të A.1 kur policia ka ardh që të marr deklaratë nga ai, unë edhe pse i kam ditur ato fakte që mi ka thënë A.1 se kush është kryesi i veprës sipas asaj që më ka thënë A.1 unë këtë nuk ia kam thënë policisë...”¹³ e për më tepër edhe vet dëshmitari A.C.1 nuk po insistonte deri në shqyrtimin gjyqësor që të tregonte faktin se edhe F.C. e dinte emrin e sulmuesit, andaj të gjitha këto fakte e bëjnë jo kredibile dëshminë e këtij dëshmitari meqë i njëjti kishte vetëm një qëllim mbështetjen e fabrikimit të dëshmitarit A.C.1 përkitazi me identitetin e personit që e kishte sulmuar natën kritike.

Po ashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve Sh.M. dhe D.R., paraqesin dëshmi të rëndësishme në këtë proces gjyqësor nga fakti se këto dëshmi janë marrë pas veprimit ex officio të trupit gjykues dhe atë me qëllim të ndriçimit sa më të plotë dhe shumëdimensional të kësaj ngjarje, përkatësisht me qëllim të vërtetimit të faktit se a kishte edhe persona tjerë që dyshohej se kishin kryer këtë vepër penale apo jo (siç pretendonte i akuzuari gjatë mbrojtjes së tij).

Nga dëshmitë e tyre vërtetohet se me këta dëshmitarë kishte pasur biseda nipi i të dëmtuarit përkitazi me faktin se kishte dyshime se edhe këta mund të kishin kryer këtë vepër penale, për më tepër kontaktet me N. nuk i mohojnë asnjëri nga dëshmitarët deri sa dëshmitari Sh.M. pohon se “...pas tri dite që kishte ndodhur rasti rastësisht jemi takuar me N.C. përndryshe i njëjti është djali i vëllait të A.1 po ashtu bashkëfshatar i imi dhe me N. kemi zhvilluar një bisedë në automjetin e tij ku i njëjti është interesuar rreth rastit që i kishte ndodhur A.1, përndryshe i njëjti më ka pyetur se mos din për ndonjë person që kishte kryer veprën ndaj A.1 po ashtu më ka pyetur se mos D. e kishte kryer këtë vepër me që i njëjti e dinte se unë shoqërohem me D.”¹⁴

Kurse dëshmitari tjetër D.R. në dëshminë e tij ka pohuar faktin se bazuar në bisedën që ka pasur me N.C. i njëjti pas bisedës me axhën e tij A.1 i kishte thënë se ky kishte kryer sulmin ndaj A.1 dhe këtë bisedë e kishin zhvilluar ditën e nesërme pas ngjarjes së ndodhur por duke pohuar se në orët e mbrëmjes është sqaruar se bëhet fjalë për një D. tjetër pa specifikuar se për cilin D. ishte fjala “... derisa unë kam qenë duke fjetur ka ardhur N.C. të cilin edhe më herët e kam njohur pasi kemi qenë të të njëjtit fshat dhe posa kam dalë nga shtëpia i njëjti më ka thënë D. mbrëmë më ka ndodhur një problem më është plagosur axha

¹³ Faqja e 15 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

¹⁴ Vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor i dt.30.07.2014

A.1 dhe më ka thënë se jam duke ardhur nga Spitali i Prishtinës dhe axha më ka thënë se plagosjen e tij e ka bërë D. duke aluduar në mua e që unë atij i kam thënë se unë nga ti po e dëgjoj këtë se unë e kam kryer këtë vepër përndryshe të garantoj me jetë se unë nuk e kam bërë këtë vepër e pastaj prap N. më tha se mixha i tij po thotë se D.”¹⁵ duke vazhduar se “...por në mbrëmje jemi takuar prap me N. edhe pse nuk kishim lënë takim me të por rastësisht jemi takuar “Te Lushi” me të, e që unë e kam hapur bisedën me N. duke i thënë se ke gabuar që ke ardh tek unë për këtë punë sepse po kam presion prej familjarëve, e që N. menjëherë më tha se e ka pyetur prap mixhën dhe i ka thënë se është tjetër D...”¹⁶

Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë objektive, të besueshme, të sakta dhe në shumë aspekte e plotësojnë njëra-tjetrën nuk e gjet ndonjë rrethanë që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtyre dëshmimeve për më tepër e qartëson faktin tejet të rëndësishëm se A.C.1 në fakt nuk ishte së paku në atë kohë (menjëherë pas ngjarjes) i sigurt se kush ishte personi që e kishte sulmuar dhe se për këtë arsye edhe po supozonte persona tjerë.

Përmes provave materiale përkatësisht nga leximi në raportin e vëzhgimit të vendit të ngjarjes bashkë me foto dokumentacionin e teknikës kriminalistike të Policisë së Kosovës – Njësia e Hetimeve Ferizaj, nga leximi i flete lëshimit të QKUK-së në Prishtinë i dt. 05.12.2011 dhe nga shikimi dhe leximi në raportin e forenzikës të dt. 29.11.2011.

Gjykata vlerëson se provat e lartshënuara janë të besueshme nga fakti se janë përpiluara nga ana e personave zyrtar, por, megjithatë të gjitha këto prova janë të natyrës objektive dhe asgjë nuk vërtetojnë në kuptimin subjektiv të saj.

5.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjithsesi për të bërë një analize gjithëpërfshirëse të të gjitha provave në një proces gjyqësor është e nevojshme të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit e cila natyrisht asnjëherë nuk duhet të vlerësohet në mënyrë fragmentare nga provat tjera dhe po ashtu edhe nga fazat tjera të procedurës penale, e që gjithsesi është e natyrshme që në rastet e tilla kur bëhet fjalë për një vepër të kësaj natyre të rëndë është pak e besueshme që nga i akuzuari të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj çështje.

¹⁵ Po aty

¹⁶ Po aty

Por, nga mbrojtja e tij shihet se ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale dhe se mbrojtja e tij është e përqendruar në sqarimin se natën kur ka ndodhur ngjarja ishte duke qëndruar në shtëpinë e tij së bashku me familjarët e tij.

Gjykata vlerëson disa karakteristika të mbrojtjes së të akuzuarit:

- se që nga faza fillestare e mbrojtjes së tij e deri në përfundim të saj ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale;

- kanë qenë konsistent dhe asnjëherë nuk ka ndryshuar mbrojtjen e tij me përjashtim dhe nuanca tejet të vogla e që këto vetëm falë sqarimit më të hollësishëm të ngjarjes;

- përjashton mundësinë e fabrikimit apo sajimit të mbrojtjes së tij posaçërisht duke u bazuar në faktin se nuk kishte kohë për diçka të tillë meqë po thuajse menjëherë pas ngjarjes ishte arrestuar;

- paraqiti mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me të gjitha provat tjera të prezantuara (pos dëshmisë së dëshmitarit A.C.1 dhe F.C.).

Megjithatë edhe nga mbrojtja e të akuzuarit nuk është arritur të vërtetohen se ka qenë i implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e kësaj vepre penale, për më tepër Gjykata me gjithë shtjellimin gjithëpërfshirës të provave nuk arriti të gjente pothuajse as edhe një fije të vetme të motivit që i akuzuari kishte për të kryer një vepër të tillë dhe kjo është edhe i vetmi rast ku i dëmtuari dhe i akuzuari janë të një qëndrimi se asnjëri nga ta nuk arriti të paraqiste ndonjë motiv të lartë për kryerjen e kësaj vepre edhe pse që të dy njiheshin mes vete kishin raporte të mira nuk kishin pasur kurrë ndonjë mosmarrëveshje as ndërmjet vete e as me familjarët e tyre, pos “motivit” që e sajoi i dëmtuari se i akuzuari kishte shkuar për të vjedhur por i cili është elaboruar hollësisht në pjesën e epërme ë këtij aktgjykimi e po ashtu edhe bazuar në faktin se po të ishte ky motiv pra i vjedhjes ekzistonte mundësia që personi i cili sulmoi të dëmtuarin të ikte nga aty duke marrë parasysh veçanërisht edhe moshën e tij të re në krahasim më të dëmtuarin i cili ishte dukshëm më i shtyer në moshë.

6. Vlerësimi i fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare fillimisht ka përshkruar rrjedhën e procedurës penale nga fillimi deri në përfundim të saj dhe duke përshkruar provat materiale e

që edhe vet e konstaton se nuk kanë qenë kontestues. Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryerës i kësaj vepre penale, por, shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm. Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet në “adutin kryesor” (dëshminë e dëshmitarit- të dëmtuarit A.C.1 i mbështetur edhe nga dëshmitari F.C.) të cilat dëshmi i ka elaboruar në hollësi duke përshkruar çdo pikë të tyre.

Por ti kthehemi dhe ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari veprimin e të akuzuarit e përshkruan në mënyrë tejet të thjeshtë dhe në vija tejet të përgjithësuara pa elaboruar hollësi dhe detaje, për më tepër e gjithë këtë veprim të tij për veprën penale të tentim vrasjes e përshkruan “... *prokuroria vlerëson se vërtet i akuzuari ditën kritike ishte në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit dhe tentoi ta privoj nga jeta duke shtënë tri herë në drejtim të tij me ç’rast një predhë kishte goditur të dëmtuarin në shpatullën e majtë e cila përshkon pjesën e shpinës dhe kalon në shpatullën e djathtë*”¹⁷, e që në fakt është më se e qartë se për ta privuar një person nga jeta duhet që për këtë i akuzuari të ketë një motiv e duke e ndërlidhur me seriozitetin e veprës penale ky motiv duhet të jetë mjaft i lartë, por përkundrazi si duket prokurori i çështjes e abstrahon në tërësi motivin si një komponentë e rëndësishme psikologjike e cila është edhe shtytëse për ndërmarrjen e një veprimi të caktuar në drejtim të kryerjes e veprës penale të caktuar e për më tepër është tejet interesante se edhe vet i dëmtuari mundohet që të gjej një motiv për këtë vepër penale “*se i akuzuari kishte shkuar për të vjedhur*”, por si duket prokurorit të çështjes kjo nuk i bën përshtypje dhe as që e potencon fare në fjalën e tij përfundimtare;

- dëshminë e dëshmitarit e përshkruan si objektive dhe të sigurtë duke potencuar se dëshmia e tij përputhet edhe me provat tjera materiale “...*Dëshmia e të dëmtuarit ka qenë në mënyrë të vazhdueshme të procedurës penale e pandryshuar dhe përputhet edhe me provat materiale që janë gjetur në vendin e ngjarjes, vërtet i dëmtuari deklaroi se kishte shtënë tri herë në drejtim të tij i akuzuari e që përputhet në tërësi me vendin e ngjarjes ku ishte bërë shikimi nga Njësia e Forenzikës e cila gjeti tri gëzhoja të shkrepara nga e njëjta armë, kjo vërtet nuk do të nënkuptonte se i akuzuari ka shtënë me armë, por, tregon në objektivitetin e dëshmisë së të dëmtuarit kur kemi të bëjmë me identifikimin e të akuzuarit, pra i dëmtuarit nuk kishte njohuri se Njësia e Forenzikës çka kishte gjetur në vendin e ngjarës dhe po të*

¹⁷ Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

konstruktonte një variant të kësaj ngjarje ai mund të kishte thënë se i akuzuari ka shtënë disa herë, e që vërtet tregon një objektivitet dhe përshkrim real të asaj që kishte ndodhur...”¹⁸

është e vërtetë se dëshmitari ishte konsistent në dëshminë e tij në të gjitha fazat e procedurës penale dhe kjo është elaboruar hollësisht në pjesën ku është trajtuar dëshmia e tij por gjithsesi këtu duhet vlerësuar se (është shkrepur tri herë me armë, është plagosur dëshmitari) janë fakte jo kontestuese, për më tepër paraqesin anën objektive dhe se edhe Gjykata pajtohet plotësisht se ngjarja ashtu edhe ka ndodhur por në rastin konkret kontestues është aspekti subjektiv se në fakt a ishte i akuzuari kryerës i kësaj vepre penale dhe se ky fakt është i rëndësishëm që të ndriçohet ;

- pretendimi tjetër se “... i dëmtuari menjëherë nuk kishte përmendur emër të ndonjë të dyshuari derisa këtë ia kishte përmendur kushëriri i tij tani dëshmitarit F.C. duhet kuptuar si një pasojë e një gjendje tronditëse që kishte pësuar i dëmtuari dhe vërtet në këto situata edhe emri i ndonjë personi shumë të afërt mund t’i humbet nga kujtesa aq më tepër kur në ato momente ishte vendimtare që të dërgohej sa më urgjent për t’iu dhënë ndihma mjekësore mirëpo i dëmtuari dëshminë e parë të dhënë para Njësisë së Hetimeve të Policisë Rajonale dhe atë një ditë pas ngjarjes derisa ishte në spital përshkroi në mënyrë detale ngjarjen që kishte ndodhur dhe identifikoi në mënyrë të sigurve tani të akuzuarin...”, Gjykata vlerëson se qëndrojnë këto pohime se gjendja emocionale e të dëmtuarit menjëherë pas ngjarjes mund të ishte situatë kur mund të mos i kujtohej emri i të akuzuarit, por në fakt i njëjti do të mund të ipte ndonjë të dhënë më të përgjithshme për të (është elaboruar hollësisht edhe me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit) e për më tepër pohimi para hetuesve policor ku përmend emrin e të akuzuarit duhet trajtohet në kontest kohor se u dha të nesërmen në mesditë (29.11.2011 fillimi i intervistës në ora 12:00) pasi që kishin kaluar disa orë nga ngjarja e këtë rrethanë duke e ndërlidhur posaçërisht me faktin se që në orët e mëngjesit të dt.29.11.2011 nipi i tij (N.C.) në saje të pohimeve të vet të dëmtuarit po zhvillonte “hetime paralele” dhe po bisedonte me persona tjerë (D.R. e më vonë edhe me Sh.M.) që po ashtu po pretendonte se kishin kryer këtë vepër penale, e për më tepër ishte pikërisht i dëmtuari që kishte mundësinë që paraprakisht gjatë transportit me autoambulancë të njoftonte për këtë edhe zyrtarin policor i cili i kishte telefonuar por i dëmtuari zgjodhi kushëririn e tij që ta “njoftoj për emrin e sulmuesit” (të cilin fakt e potencoi vetëm në shqyrtimin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë);

¹⁸ Po aty

-në fund prokurori i referohet me disa fjali edhe mbrojtjes së të akuzuarit duke e përshkruar si një mbrojtje kontradiktore duke vlerësuar mbrojtjen e tij prej fazës në fazë të procedurës, megjithatë Gjykata vlerëson se përkundrazi mbrojtja e të akuzuarit ishte e qëndrueshme dhe konsistente në çdo fazë të procedurës meqë i njëjti kategorikisht mohoi kryerjen e kësaj vepre penale për më tepër i njëjti përshkroi aktivitetet e tij të kryera gjatë tërë ditës kritike kur kishte ndodhur ngjarja dhe gjithsesi në polici ato i paraqiti në mënyrë më të thjeshtë kurse tek prokurori i shtetit i përshkroi ato në hollësi kurse në shqyrtimet gjyqësore i detajizoi ato deri në detajet më të imta.

Sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par.1 të KPK-së, Gjykata vlerëson se kjo vepër penale është derivat i veprës së parë penale e për më tepër revolja e supozuar se u përdor nuk u gjet fare edhe pse nuk ishte kontestues fakti se me një revole ishte qëlluar i dëmtuari por kjo paraqet anën objektive të kësaj vepre penale, andaj mbi këtë bazë është e panevojshme që të trajtohet më tutje kjo pjesë e aktgjykimit.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

7.Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 112 par.3 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin A.C.1, që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizoj në kontest civil.

Konform nenit 103 par.1 të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me PKR.nr.36/2014

Sekretarja juridike,

Albana Ajvazi

Kryetari i trupit gjykues,

Agim MALIQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.